



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201400740/2

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandojmë nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 11 të Ligjit nr.26/2012 "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 8098 datë 28.03.1996 "Për Statusin e të Verbërit"; të nenit 11 të Ligjit nr. 27/2012 "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 8626 datë 22.06.2000 "Për Statusin e Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik", të ndryshuar; të nenit 11 të Ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 "Për Statusin e Invalidit"; të nenit 10 të Ligjit nr.8153 datë 31.10.1996 "Për Statusin e Jetimit" si dhe të nenit 6 të Ligjit nr.7663 datë 20.01.1993 "Lufta kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar".*

Drejtuar: **Z. Edmond HAXHINASTO**
Ministër i Punëve Publike dhe Transportit

Z. Erjon VELIAJ
Ministër i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë

Z. Shkëlqim CANI
Ministër i Financave

TIRANË

Të nderuar zotërinj Ministra,

Ratifikimi nga shteti shqiptar i Konventës së OKB-së "Mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara", duhet të zgjerojë të drejtat dhe përfitimet për personat me aftësi të kufizuara dhe t'u sigurojë atyre gëzimin e të gjitha të drejtave për jetesë normale dhe pa barriera. Një nga parimet themelore mbi të

cilat bazohet kjo Konventë është ai i barazisë dhe mosdiskriminimit. Sipas këtij parimi shtetet palë pranojnë se të gjithë personat janë të barabartë përpara ligjit dhe se gëzojnë të drejtën pa asnjë diskriminim, për mbrojtje të barabartë dhe përfitim të barabartë nga ligji.

Në përmbushje të detyrës sonë kushtetuese dhe ligjore në mbrojtje të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, nga analiza e dispozitave ligjore e nënligjore që rregullojnë këtë çështje, konstatojmë se:

-Ligji nr. 26/2012 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 8098 datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, të ndryshuar, në nenin 11 ka përcaktuar se:

“Të verbërit dhe shoqëruesit e tyre përfitojnë kompensim për shërbimin e transportit. Masa dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

--Ligji nr. 27/2012 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 8626 datë 22.06.2000 “Për Statusin e Invalidit Praplegjik dhe Tetraplegjik”, të ndryshuar në nenin 11 ka përcaktuar se:

“Të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe shoqëruesit e tyre përfitojnë kompensim për shërbimin e transportit. Masa dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Sa më lart, rezulton se ende nuk ka dalë asnjë akt nënligjor në zbatim të ligjeve të sipërcituara si dhe në zbatim të nenit 11 të Ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 “Për Statusin e Invalidit”; të nenit 10 të Ligjit nr.8153 datë 31.10.1996 “Për Statusin e Jetimit” si dhe të nenit 6 të Ligjit nr.7663 datë 20.01.1993 “Lufta kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”.

Siç shihet, ndonëse ligji ua njeh të drejtën e përfitimit ai nuk ka gjetur zbatim, pasi nuk ka asnjë akt nënligjor me të cilin të rregullohet situata e këtyre kategorive përfituese.

Për sa më sipër, me qëllim që subjektet e së drejtës të gëzojnë të drejtat e tyre ligjore, në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës, ku thuhet shprehimisht se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive ë njeriut nga administrata publike”,* dhe në vijim të nenit 21/b ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,*

REKOMANDOJMË:

Nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 11 të Ligjit nr.26/2012 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 8098 datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”; të nenit 11 të Ligjit nr. 27/2012 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 8626 datë 22.06.2000 “Për Statusin e Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik”, të ndryshuar; të nenit 11 të Ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 “Për Statusin e Invalidit”; të nenit 10 të Ligjit nr.8153 datë 31.10.1996 “Për Statusin e Jetimit” si dhe të nenit 6 të Ligjit nr.7663 datë 20.01.1993 “Lufta kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, plotësuar me Ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me Ligjin nr.9398, datë 12.05.2005, ku thuhet shprehimisht se;

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”, lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi, brenda 30 ditëve.

Me respekt

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Konc.M.Morina
dt.28. 04.2014